▷ göra anteckningar – marr shënime

▷ minnesanteckning – shënime kujtimesth, kujtime

▷ antecknings/bok – fletore shënimesh

antenn [ant'en:] *subst.* **antenn,**

antennen, antenner

antenë (edhe për brirthat në kokën e disa kandrrave)

▷ TV-antenn – antenë e televizorit

antik [ant'i:k] *adj.* **antik, antikt,**

antika

▷ en antik byrå – një komo antike

antik, ~e (lashtë (i, e))

antiken [ant'i:ken] *subst.* **antiken,**

antiken

lashtësi (antikitet, periudhë antike)

antikvariat [antikvari'a:t] *subst.*

antikvariat, antikariatet,

antikariatien

antikuariat

▷ bokhandel som köper och säljer (värdefulla) begagnade böcker –

librari ku blihen dhe shiten libra të vjetër (me vlerë)

antingen [2'an:tingen] *konj.*

ose, apo

▷ antingen du eller jag – ose ti, ose unë, ti ose unë

antyder [2'an:ty:der] *verb*

antyder, antydde, antytt, antyd,
antya

aludoj (lë të kuptohet)

antänder [2'an:ten:der] *verb*

antänder, antände, antänt,

antänd, antända

vë zjarr (ndez, djeg)

anvisning [2'an:vi:sning] *subst.*

anvisning, anvisningen,
anvisningar

udhëzim (rekomandim, këshillë)

▷ råd och anvisningar – këshilla dhe rekomandime

använder [2'an:ven:der] *verb*

använder, använde, använt,

använd, använda

përdor (shfrytëzoi)

▷ använd bilbältet! – përdor rripin e veturës!

▷ använda sig av en ny metod – përdor një metodë të re

apa [2'a:pa] *subst.* **apa, apan, apor**

majmun (edhe *fig.* person që shkërben (imiton))

apelsin [apels'i:n] *subst.* **apelsin,**

apelsinen, apelsiner

portokall

▷ apelsin/juice – lëng portokalli

▷ apelsin/marmelad – marmelatë portokalli

apostrof [apostr'â:f] *subst.*

apostrof, apostrofen, apostrofer

apostrof

apotek [apot'e:k] *subst.* **apotek,**

apoteket, apotek, apoteken

barnatore, farmaci

apparat [apar'a:t] *subst.* **apparat, apparaten, apparater** **apparat aparat** (instrument; makineri

▷ elektroniska apparater – aparate elektronike

▷ den byråkratiska apparaten – aparat burokratik

applåd [apl'å:d] *subst.* **applåd, applåden, applåder duartrokitje**

applåderar [aplåd'e:rar] *verb* **applåderar, applåderade, applåderat, applådera duartrokas**

▷ publiken applåderade villigt – publiku duartrokiste me gëzim

aprikos [aprik'o:s] *subst.* **aprikos, aprikosen, aprikoser kajsi** (frutë e pemës *Prunus armenica*)

april [apr'il:] *subst.* årets fjärde månad **prill**

apropå [aprop'å:] *prep.*

atëherë (meqë ra fjala për)

aptit [apt'i:t] *subst.* **aptit, aptiten oreks** (dëshirë e madhe (për diçka), të ngrënët me shije, ëndje për të ngrënë)

arab [ar'a:b] *subst.* **arab, araben, araber, araberna**

arab (person që i përket një populli arabishtfolës)

arbetar [²'ar:be:tar] *verb* **arbetar, arbetade, arbetat, arbeta**

punoj (veproj, bëj (kryej) një punë)

▷ arbeta på fabrik – punoj në fabrikë

arbetare [²'ar:be:tare] *subst.*

arbetare, arbetaren, arbetare, arbetarna

punëtor (person që kryen punë fizike)

▷ industriarbetare – punëtor në industri
▷ byggnadsarbetare – punëtor ndërtimi

▷ kulturarbetare – punëtor në lëmin e kulturës

arbete [²'ar:be:te] *subst.* **arbete, arbetet, arbeten, arbetena punë, shërbim** (punësim, mjeshtëri)

▷ söka arbete – kërkoi punë

arbetsam [²'ar:be:tsam:]

adj. **arbetsam, arbetsamt, arbetsamma**

mundimsh/ëm (i), ~me (e) (lodhsh/ëm (i), ~me (e), rëndë (i, e))

▷ jag har haft en arbetsam vecka – kam patur një javë të lodhshme

arbets/förmedling

[²'ar:be:tsförme:dling] *subst.*

~förmedling, ~förmedlingen, ~förmedlingar

zyrë pune

▷ Arbetsförmedlingen

informerar också om läget på arbetsmarknaden – Zyra e punës informon gjithashtu edhe për gjendjen në tregun e punës.

arbets/givare [²'ar:be:tsji:vare]

subst. **~givare, ~givaren, ~givare, ~givarna**

punëdhënës

▷ arbetsgivar/uppgift – raport vjetor i punëdhënësit

▷ Arbetsgivare/föreningen – Shoqata e Punëdhënësve

arbetslös [²'ar:be:tslö:s] *adj.*

arbetslös, arbetslöst, arbetslösa papunë (i, e)

▷ bli arbetslös – mbetem pa punë

▷ gå arbetslös – mbetem pa punë

arbets/marknad

[²'ar:be:tsmar:knad] *subst.*

~marknad, ~marknaden,

~marknader

tregu i punës

▷ arbetsmarknadens parter – palë në tregun e punës

▷ på arbetsmarknaden – në tregun e punës

arbets/plats [²'ar:be:tsplat:s]

subst. ~plats, ~platsen, ~platser
vend pune (punë)

arg [ar:] *adj.* arg, argt, arga

indinjuar (i, e) (zemëruar (i, e),
egërsuar (i, e))

▷ varför blev hon arg på dig? –
pse u zemërua ajo me ty?

▷ en arg hund – një qen i egërsuar

argument [argum'en:t] *subst.*

argument, argumentet,

argument, argumenten

argument (arsye, shkak)

aria ['a:rja] *sust.* aria, arian, arior

arie (pjesë e një opere ose
operete)

▷ operaaria – arie opere

arkitekt [arkit'ek:t] *subst.* arkitekt,

arkitekten, arkitekter

arkitekt

▷ inrednings/arkitekt – arkitekt
interierësh, arkitekt për mjediset e
brendshme

arkiv [ark'i:v] *subst.* arkiv, arkivet,

arkiv, arkiven

arkiv

▷ landsarkiv – arkiv shteti

arm [ar:m] *subst.* arm, armen,

armar

krah

▷ gå arm i arm – shkoj dorë për
dore, eci krah për krah

arm/band [²'ar:mban:d] *subst.*

~band, ~bandet, ~band, ~banden
byzlyk

armbands/ur [²'ar:mbandsu:r]

subst. ~ur, ~uret, ~ur, ~en
orë dore

armé [arm'e:] *subst.* armé, armén,

arméer

ushtri

▷ armén, marinen och flygvapnet
– ushtri, flotë detare dhe ajrore

arm/håla [²'ar:mhå:la] *subst.* ~håla,

~hålan, ~hålör

sqetull

arom [ar'å:m] *subst.* arom, aromen,

aromer

aromë (në lidhje me diçka që
hahet) erë e mirë))

arrangemang [aransjem'ang:]

subst. arrangemang,

arrangemanget, arrangemangen

shfaqje (veprimtari, aktivitet)

arrangerar [aransj'e:rar]

verb arrangerar, arrangerade,
arrangerat, arrangerar

përgatit (organizoj, planifikoj)

arrangör [aransj'ö:r] *subst.*

arrangör, arrangören, arrangörer

aranzhues (organizues,
organizator)

▷ klubben står som arrangör för
tävlingen – klubi është organizator
i garës

arrest [ar'es:t] *subst.* arrest,

arresten, arrester

arrest (vend arresti, paraburgim)

▷ arrest/lokal – ndërtesë
ku mbahen të arrestuarit (të
paraburgosurit)

▷ husarrest – arrest shtëpie

▷ arrest/lokal – ndërtesë
ku mbahen të arrestuarit (të
paraburgosurit)

arresterar [arest'e:rar] *verb* arresterar,

arresterade, arresterat, arresterar

arrestoj, paraburgos (për kushte
josuedeze)

arrogant [arog'an:t] *adj.* arrogant,

arrogant, arroganta

arrogant, ~e

▷ ett arrogant svar – një përgjigje
arrogante

arsle [²'ar_s:le el.²'ar_s:el] *subst.* arslle,

arslet, arslen

bythë (në *ligj e përdit.*; me përç. edhe për njerëz) (prapanicë, të ndenjura)

art [a:r_t] *subst.* **art, arten, arter lloj** (soj, tip, farë)

▷ huset är unikt i sin art – shtëpia është unike në llojin e vet

artig [ʔ'a:r_tig] *adj.* **artig, artigt, artiga sjellsh/ëm (i), ~me (e)** (njerëzish/ëm (i), ~me (e))

▷ artighet – mirësjellje, njerëzi

artikel [ar_t'ik:el] *subst.* **artikel, artikeln, artiklar artikull**

▷ skriva en artikel i tidningen – shkruaj një artikull për gazetën

▷ tidningsartikel – artikull gazete

▷ artikel/serie – seri artikujsh

artilleri [ar_tiler'i:] *subst.* **artilleri, artilleriet**

artileri (tërësi armësh luftarake të rënda)

artist [ar_t'is:t] *subst.* **artist, artisten, artister**

artist (aktor)

▷ artisteri – punë artistike, punë mjeshtri, mjeshtri

arton [ʔ'a:r_tån] *räkn.*

tetëmbëdhjetë (18)

▷ artonde – tetëmbëdhjetë/ë, ~i (i)

artär [ar_t'ä:r] *subst.* **artär, artären, artärer**

arterie (enë gjaku)

arv [ar:v] *subst.* **arv, arvet, arv, arven trashëgim** (trashëgimi)

▷ gården gick i arv från far till son – prona kaloi në trashëgim nga i ati tek i biri

▷ arv och miljö – trashëgimia dhe mjedisi

asfalt [ʔ'as:fal:t] *subst.* **asfalt, asfalten bitum, asfalt**

asfalterar [asfalt'e:rar] *verb*

asfalterar, asfalterade, asfalterat, asfaltera

bitumoj (asfaltoj, shtroj me asfalt)

asiat [asi'a:t] *subst.* **asiat, asiaten, asiater**

aziatik, ~u (banor i Azisë)

asiatisk [asi'a:tisk] *adj.* **asiatisk, asiatiskt, asiatiska**

aziatik, ~e (që është nga Azia ose që i përket Azisë)

ask [as:k] *subst.* **ask, asken, askar kutizë**

▷ en ask tändstickor – një kuti me shkrepëse

▷ tändsticksask – kuti shkrepësesh

asp [as:p] *subst.* **asp, aspen, aspar plep i egër** (druri *Populus tremula*)

aspekt [asp'ek:t] *subst.* **aspekt, aspekten, aspekter**

aspekt (pikëpamje, këndvështrim)

▷ behandla en fråga ur olika aspekter – trajtoj një çështje nga këndvështrime të ndryshme

assiett [asj'et:] *subst.* **assiett, assietten, assietter pjatëz**

assistent [asist'en:t] *subst.*

assistent, assistenten,

assistenter

asistent (ndihmës, bashkëpunëtor, nëpunës, zëvendës)

▷ socialassistent – punonjës social

▷ direktörsassistent – ndihmësdrejtor, nëndrejtor

association [asosiasj'o:n] *subst.*

association, associationen,

associationer

shoqatë

▷ associations/förmåga – aftësi për të krijuar shoqata

astma [ʔas:tma] *subst.* **astma, astman**
astmë (shpirrë, gulçim, sëmundje
 alergjike që shfaqet me shqetësime
 në frymëmarrje)

▷ astma/anfall – krizë astme

astrologji [astrolåg'i:] *subst.*

astrologi, astrologien

astrologji

astronaut [astron'a_ot] *subst.*

astronaut, astronauten,

astronauter

astronaut

asyl [as'y:l] *subst.* **asyl, asylen,**

asyler

strehim (mbrojtje)

▷ söka (el. begära) (politisk) asyl –
 kërkuj strehim (politik)

▷ få asyl – fitoj strehim politik

ateist [ate'is:t] *subst.* **ateist,**

ateisten, ateister

ateist (ai/ajo që nuk beson në zot,
 pafe (i, e)

ateljé [atelj'e:] *subst.* **ateljé, ateljén,**

ateljéer

atelier (studio pune për artistët)

atlas ['at:las] *subst.* **atlas, atlasen,**

atlaser

atlas

▷ världsatlas – atlas i botës

atmosfär [atmosf'ä:r] *subst.*

atmosfär, atmosfären, atmosfärer

atmosferë

▷ jordatmosfär – atmosfera e Tokës

atom [at'å:m] *subst.* **atom, atomen,**

atomer

atom (grimca më e vogël e çdo
 elementi kimik); edhe si parashtesë
 në fjalët e përbëra në kuptimin
 “energji bërthamore”)

atom/bomb [ʔat'å:mbåm:b] *subst.*

~bomb, ~bomben, ~bomber

bomba atomike (bombë me
 mbushje bërthamore)

attack [at'ak:] *subst.* **attack,**

attacken, attacker jämför “anfall”

sulm (edhe për sëmundje akute)

(mësymje, atak)

▷ flygattack – sulm ajror

▷ hjärtattack – sulm (atak) në
 zemër, krizë zemre

attackerar [atak'e:rar] *verb*

attackerar, attackerade,

attackerat, attackera

sulmoj (mësyj, atakoj)

attentat [atent'a:t] *subst.* **attentat,**

attentatet, attentat, attentaten

atentat

attityd [atit'y:d] *subst.* **attityd,**

attityden, attityder

qëndrim (sjellje, pikëpamje)

▷ attityd/förändring – ndryshim
 qëndrimi (sjelljeje)

attraktiv [atrakt'i:v (el. 'at:-)] *adj.*

attraktiv, attraktivt, attraktiva

tërheqës, ~e (joshës, ~e, atraktiv,
 ~e)

augusti [a_og'us:ti] *subst.*

gusht (muaji i tetë i vitit)

auktion [a_oksjo'n] *subst.* **auktion,**

auktionen, auktioner

ankand

▷ köpa på exekutiv auktion – blej
 në një ankand detyrimi

auktoritet [a_oktorit'e:t] *subst.*

auktoritet, auktoriteten,

auktoriteter

autoritet (person që nderohet
 (respektohet))

australisk [a_ostr'a:lisk]

adj. **australisk, australiskt,**

australiska

australian, ~e (që është nga

Australia ose i përket Australisë)

autograf [a_otogr'a:f] *subst.*

autograf, autografen, autografer

autograf (nënshkrim, firmosje)

automat [a_otom'a:t] *subst.*

automat, automaten, automater

automat (makinë apo aparat që punon në mënyrë automatike)

▷ kaffeautomat – automat për kafe

▷ spelautomat – automat argëtimi

▷ automat/svarv – tornu automatike

automatisk [a_otom'a:tisk]

adj. **automatisk, automatiskt,**

automatiska

automatik, ~e (vetëveprues, ~e, mekanik, ~e)

▷ automatisk växellåda – kuti

shpejtësie automatike, kamio

automatike

av [a:v] *prep.*

nga, prej

anger upphov till sak eller händelse (shpreh prejardhjen e diçkaje)

▷ tavlan är målad av Chagall –

tabloja është piktuar nga Shagali

▷ av en slump – rastësisht

av [a:v] *adv.* användning:

verbpartikel; anger avbrott i ett förlopp

(pjesëz foljore)

▷ blåsa av en tävling – i bie bilbilit

për të shënuar përfundimin e një gare

▷ stänga av en kran – mbyll

rubinetin e çezmës

avancerad [avans'e:rad] *adj.*

avancerad, avancerat,

avancerade

avancuar (i, e) (zhvilluar (i, e),

përsosur (i, e), sofistikuuar (i, e);

guximsh/ëm (i), ~me (e)

▷ avancerad utrustning – pajisje e sofistikuuar

▷ avancerad flygning – akrobaci

ajrore e guximshme

avbeställer [²'a:vbestel:er]

verb **avbeställer, avbeställde,**

avbeställt, avbeställ, ~a

anuloj (shfuqizoj, zhvleftësoj, prish,

nuk e lejoj të bëhet, kthej mbrapsht

▷ avbeställning – shfuqizim,

anulim, zhvleftësim

▷ avbeställningskydd – sigurim

nga anulimi

avbetalning [²'a:vbetal:ning] *subst.*

avbetalning, avbetalningen,

avbetalnin

pagesë me këste

▷ köpa på avbetalning – blej me këste

avbrott [²'a:vbråt:] *subst.* **avbrott,**

avbrottet, avbrott, avbrotten

ndërprerje (ndalim, pauzë)

▷ strömavbrott – ndërprerje e energjisë elektrike

avbryter [²'a:vbyr:ter] *verb*

avbryter, avbröt, avbrutit, avbryt,

avbryta

ndërpres (ndaloj, ndal)

▷ vi fortsatte vår avbrutna resa –

ne vijuaam udhëtimin e ndërprerë

av/bytare [²'a:vby:tare] *subst.*

~bytare, ~bytaren, ~bytare,

~bytarna

zëvendës (zëvendësues, person

që zëvendëson përkohësisht një

person tjetër në punë)

avdelning [²'a:vde:ning] *subst.*

avdelning, avdelningen,

avdelningar

repart (për lokalim, personelin

ose veprimtarinë) (sektor, drejtori

(në një ndërmarrje, spital ose në

shërbimin civil))

▷ sjukavdelning – repart i të

sëmurëve

▷ kirurgisk avdelning – repart i

kirurgjisë

avdrag [²'a:vdra:g] *subst.* **avdrag,**

avdraget, avdrag, avdragen

ndalje (zbritje (nga paga))

- ▷ skatteavdrag – zbritje e tatimeve
- ▷ reseavdrag – ndalesë në pagë për udhëtimin nga dhe për në punë
- ▷ avdrags/rätt – e drejtë e zbritjeve (në taksa)

avdunstar [²'a:vdun:star]

verb **avdunstar, avdunstade, avdunstat, avdunsta avulloj** (avullon, bëhet gaz ose avull)

- ▷ vattnet avdunstade snabbt i värmen – uji avulloi shpejt nga nxehtësia

aveny [aven'y:] *subst.* **aveny, avenyn, avenyer**

shëtitore (rrugë e gjerë me pemë a drunj anash)

avfall [²'a:vfal:] *subst.* **avfall, avfallet**

mbeturina (hedhurina, lëmishte, plehra)

- ▷ samla avfall i sopsäckar – mbledh mbeturinat në thasët e plehrave
- ▷ radioaktivt avfall – mbeturina radioaktive

avfart [²'a:vfa:r_t] *subst.* **avfart, avfarten, avfarter**

dalje (e veturës) nga rruga))

avföring [²'a:vfö:ring] *subst.*

avföring, avföringen, avföringar

jashtëqitje (të pëgëra, mut)

- ▷ blod i avföringen – gjak në jashtëqitje

▷ avföringsmedel – klizmë, mjet për jashtëqitje

avgas [²'a:vga:s] *subst.* **avgas, avgasen, avgaser**

gazra dalëse

- ▷ bilavgaser – gazrat e veturës
- ▷ avgas/rening – spastrim i gazrave dalëse
- ▷ avgas/system – aparat për nxjerrjen e gazrave

- ▷ avgas/rör – gyp (tub) gazi

avgift [²'a:vjif:t] *subst.* **avgift, avgiften, avgifter**

taksë (tarifë, pagesë)

- ▷ höjda avgifter på tobak och sprit – taksa të larta për duhanin dhe alkoolin

▷ inträdesavgift – taksë hyrjeje

▷ medlemsavgift – taksë anëtarësie

▷ parkeringsavgift – taksë parkimi

▷ avgifts/höjning – rritje taksash

avgudar [²'a:vgu:dar] *verb*

avgudar, avgudade, avgudat, avguda

adhuroj (hyjnizoj)

- ▷ hon avgudade sin far – ajo e adhuron të atin

avgår [²'a:vgå:r] *verb* **avgår, avgick, avgått, avgå**

dorëhiqem (jap dorëheqjen nga një post a detyrë)

- ▷ han avgår med pension nästa år – ai del në pension vitin e ardhshëm

avgång [²'a:vgång:] *subst.* **avgång, avgången, avgångar**

dorëheqje (largim, shkëputje (nga puna))

- ▷ avgångs/bidrag – ndihmë në të holla për të papunët

▷ avgångs/vederlag – kompensim për të papunët

avgör [²'a:vjö:r] *verb* **avgör,**

avgjorde, avgjort, avgör, avgöra vendos (gjykoj, marr një vendim)

- ▷ få avgörande betydelse för utvecklingen – merr rëndësi vendimtare për zhvillimin

avgörande [²'a:vjö:rande] *adj.*

vendimtar, ~e (rëndësish/ëm (i), ~me (e), përcaktues, ~e)

- ▷ ha avgörande inflytande på – kam ndikim përcaktues (tek, te, në)

- ▷ få avgörande betydelse för utvecklingen – merr rëndësi vendimtare për zhvillimin
- ▷ ha avgörande inflytande på – kam ndikim përcaktues (tek, te, në)
- ▷ spela en avgörande roll – luan një rol vendimtar

avhandling [²'a:vhan:dling] *subst.*

avhandling, avhandlingen, avhandlingar

disertacion (doktoratë, temë shkencore)

avkoppling [²'a:vkåp:ling] *subst.*

avkoppling, avkopplingen jämför “kopplar av”

çlodhje (pushim, dëfrim, argëtim)

avlider [²'a:vli:der] *verb* **avlider,**

avled, avlidit, avlida

vdes

- ▷ han avled vid 52 års ålder – ai vdiq në moshën 52-vjeçare
- ▷ den avlidne författaren – shkrimtari i ndjerë

avlivar [²'a:vli:var] *verb* **avlivar,**

avlivade, avlivat, avliva

vras (*zakon.* për kafshët; por edhe *fig.* mohoj, hedh poshtë) (ekzekutoj)

▷ hästen måste avlivas – kali duhet vrarë

▷ avliva ett rykte – mohoj një thashethem

avlopp [²'a:vlåp:] *subst.* **avlopp,**

avloppet, avlopp, avloppen

kanalizim (i ujërave të zeza)

▷ vatten och avlopp – kanalizimi i ujërave të bardha dhe të zeza

▷ avloppet från husen rinner ut i sjön – kanalizimet e ujërave të zeza të shtëpive derdhen në liqen

avlyssnar [²'a:vlÿs:nar] *verb*

avlyssnar, avlyssnade, avlyssnat, avlyssna

përgjoj (dëgjoj (në fshehtësi))

▷ avlyssning – përgjim

avlång [²'a:vlång:] *adj.* **avlång, avlångt, avlånga**

vezak, ~e (zgjatür (i, e), oval, ~e, eliptik, ~e)

avlägsen [²'a:vlä:gsen] *adj.*

avlägsen, avlägset, avlägsna largët (i, e)

▷ avlägsna byar – fshatra të largëta

▷ i en avlägsen framtid – në një të ardhme të largët

avokado [avok'a:do] *subst.*

avokado, avokadon, avokador

avokado (një pemë tropikale)

avresa [²'a:vre:sa] *subst.* **avresa,**

avresan

nisje (ikje, shkuarje, largim)

avråder [²'a:vrå:der] *verb*

avråder, avrådde, avrätt, avråd,

avråda

këshilloj (dikë të mos bëjë diçka), i kthej mendjen dikujt)

▷ turisterna avråds från att besöka området – turistët këshillohen të mos e vizitojnë zonën

avrättar [²'a:vret:ar] *verb* **avrättar,**

avrättade, avrättat, avrätta

ekzekutoj (pushkatoj, lejoj ekzekutimin e një dënimi me vdekje)

▷ avrättning – ekzekutim

avser [²'a:vse:r] *verb* **avser, avsåg,**

avsett, avse

synoj (mendoj të, kam qëllim të, përcaktoj si qëllim, destinoj)

▷ kommunen avser att ändra planerna – komuna synon t'i ndryshojë planet

▷ bestämmelsen avser endast motorvägar – dispozita përcakton si qëllim

avsevärd [²'a:vse:vä:r_d] *adj.*

avsevärd, avsevårt, avsevärda

konsideruesh/ëm (i), ~me (e)

(zyrt.) (rëndësish/ëm (i), ~me (e))

▷ under avsevärd tid – brenda një kohe të konsiderueshme

▷ avsevårda förändringar – ndryshime të konsiderueshme

avslides [²a:vsɪ:des] *adv.*

mënjane (larg)

▷ huset ligger avslides – shtëpia ndodhet diku larg

avsikt [²a:vsɪk:t] *subst.* **avsikt,**

avsikten, avsikter

qëllim (mendim, dëshirë, synim)

▷ avsikten med kampanjen är att spara energi – synimi i fushatës është të kursehet energjia elektrike

avsiktlig [²a:vsɪk:tɪg] *adj.* **avsiktlig,**

avsiktligt, avsiktliga

qëllimsh/ëm (i), ~me (e)

(paramenduar (i, e), planifikuar (i, e), tendencioz, ~e

avskaffar [²a:vska:f:ar] *verb*

avskaffar, avskaffade, avskaffat, avskaffa

heq (shfuqizoj, abrogoj (një ligj))

▷ avskaffa betygen i skolan! – hiqni notat në shkollë!

avsked [²a:vsje:d] *subst.* **avsked,**

avskedet, avsked, avskeden

përshëndetje lamtumire

▷ han tog avsked av sin mor – ai u përshëndet (u nda) nga e ëma

▷ avskeds/brev – letër lamtumire

avskedar [²a:vsje:dar] *verb*

avskedar, avskedade, avskedat, avskeda

largoj nga puna (pushoj nga puna)

▷ fabriken avskedade 100 arbetare – fabrika pushoi nga puna 100 punëtorë

avskracker [²a:vskre:k:er]

verb **avskracker, avskräckte,**

avskräckt, avskräck, ~avskräcka

frikësoj (tmerroj, tremb)

avsky [²a:vsjy:] *subst.* **avsky, avskyn**

neveri (krupë, antipati, përbuzje, të pështirë)

▷ känna avsky (för) – ndiej neveri (për)

avskyvård [²a:vsjy:vä:r_d]

adj. **avskyvård, avskyvärt,**

avskyvårda

neveritsh/ëm (i), ~me (e) (ndyrë (i,

e), urryer (i, e), gërditsh/ëm (i), ~me (e))

avslutar [²a:vslu:tar] *verb* **avslutar,**

avslutade, avslutat, avsluta

përfundoj (kryej, mbaroj, mbyll)

▷ mötet avslutades med middag – mbledhja u mbyll me një darkë

▷ efter avslutade studier – pas kryerjes së studimeve

avslutning [²a:vslu:tning] *subst.*

avslutning, avslutningen,

avslutningar

përfundim (kryerje, fund, mbarim, mbyllje

▷ skolavslutning – festë për mbarimin e vitit shkollor

▷ avslutnings/dag – dita përfundimtare, dita e fundit

avslöjar [²a:vsLöj:ar] *verb* **avslöjar,**

avslöjade, avslöjat, avslöja

zbuloj (diktoj, nxjerr në shesh)

▷ jag vill inte avslöja mina planer – nuk dua t'i zbuloj planet e mia

avsnitt [²a:vsnit:] *subst.* **avsnitt,**

avsnittet, avsnitt, avsnitten

pjesë (fragment, copë e shkëputur)

▷ TV-serien görs i sex avsnitt – seria televizive do të ketë gjashtë pjesë

▷ textavsnitt – fragment teksti

avspänd [²a:vspen:d] *adj.*

avspänd, avspänt, avspända

shtendosur (i, e) (qetë (i, e), urtë (i, e))

▷ en avspänd atmosfär – një atmosferë e qetë, një atmosferë e shtendosur

avstår [²'a:vstâ:r] *verb* **avstår, avstod, avstått, avstå**

heq dorë (braktis, abstenoj, lë)

▷ hon avstod inte från sina krav – ajo nuk hoqi dorë nga kërkesat e veta

avstånd [²'a:vstân:d] *subst.*

avstånd, avståndet, avstånd, avstånd

largësi (edhe për kohën) (distancë)

▷ på långt avstånd – në largësi të madhe

avsändare [²'a:vsen:dare]

subst. **avsändare, avsändaren, avsändare, ~na**
dërgues

avtags/väg [²'a:vta:gsvä:g] *subst.*

~väg, ~vägen, ~vägar

degëzim rruge (rrugë anësore)

avtal [²'a:vta:l] *subst.* **avtal, avtalet, avtal, avtalen**

kontratë, marrëveshje (konventë, traktat)

▷ enligt gällande avtal – sipas marrëveshjes në fuqi

▷ avtals/villkor – kushtet e kontratës

avtalar [²'a:vta:lar] *verb* **avtalar, avtalade, avtalat, avtala**

pranoj (pajtohem, jam i një mendjeje me, jam (bie) dakord)

▷ vi möttes på avtalad tid – ne u takuam në kohën e caktuar (për të cilën kishim rënë dakord)

avund [²'a:vun:d] *subst.* **avund, avunden**

zili (lakmi, smirë)

▷ se med avund på – shikoj (diçka) me smirë

▷ väcka avund – nxit (ngjall) smirën (tek dikush)

avund/sjuk [²'a:vundsju:k] *adj.*

~sjuk, ~sjukt, ~sjuka

xheloz, ~e (ziliqar, ~e, lakmitar, ~e)

avvisar [²'a:vi:sar] *verb* **avvisar, avvisade, avvisat, avvisa**

dëboj (refuzoj, kthej, hedh poshtë, nuk pranoj, kthej mbrapsht)

▷ flyktingarna avvisades vid gränsen – refugjatët u kthyen në kufi

ax [ak:s] *subst.* **ax, axet, ax, axen**
kalli (vrigull)

axel [²'ak:sel] *subst.* **axel, axeln, axlar**

bosht, ~i (bosht i rrotullimit, aks)

▷ axel/tryck – ngarkesë në bosht, forcë shtytëse në bosht

B, b

babblar [ʔb'ab:lar] *verb* **babblar**,
babblade, **babblat**, **babbla**

llomotit (dërdëllit, flas pa lidhje)

babord [b'a:bo:r_d] *subst.* vänster
sida på en båt (sett från aktern)-
bord i majtë (ana e majtë e anijes)

baby [b'ej:bi el. b'ä:bis el. b'e:bis]
subst. **baby**, **babyn**, **babyar**
foshnjë (bebe, kërthi)

bacill [bas'il:] *subst.* **bacill**, **bacillen**,
baciller

bacil (*shpr. joprof.*) (bakter)

▷ **bacill/skräck** – frikë nga bacilet

back , [bak:] *subst.* **back**, **backen**,
backar

arkë (kuvli, kuti)

▷ **ölback** – arkë birrash

back , [bak:] *adv.*

pas, **prapa** (në *ligj e përdit.*) (nga
prapa, së prapi)

backe [ʔb'ak:e] *subst.* **backe**,
backen, **backar**

pjerrësi (edhe për pistë rrëshqitjeje,
pistë për ski) (rrëpirë, bregore,
kodrinë, shpat)

▷ **uppförbacke** – vend i pjerrët (në
ngjitje)

▷ **skogsbacke** – rrëpirë pylli

▷ **hoppbacke** – kërcimore
(trampolinë), pistë kërcimi për ski

bacon [b'ej:kån] *subst.* **bacon**,
baconet

pastërma derri

bad , [ba:d] *subst.* **bad**, **badet**, **bad**,
baden

banjë, **nevojto**, **WC** (vend
banjash, banjë publike)

bad , [ba:d] *subst.* **bad**, **badet**, **bad**,
baden

banjë (edhe për lëngje të tjera)
(dush, kredhje në ujë)

▷ **bad/byxa** – mbathje plazhi

▷ **bad/plats** – qendër klimaterike
bregdetare

▷ **bad/strand** – plazh, bregdet

baddar [ʔb'ad:ar] *verb* **baddar**,
baddade, **baddat**, **badda**

laj, **njom**, **qull** (pastroj me ujë,
shpëlaj, lahem, bëj banjë)

▷ **badda ett sår** – laj një plagë,
shpëlaj një plagë

bad/dräkt [ʔb'a:drek:t] *subst.*

~dräkt, **~dräkten**, **~dräkter**

rroba banje

bad/kar [ʔb'a:dka:r] *subst.* **~kar**,
~karet, **~kar**, **~karen**

vaskë

badminton [b'ed:mintån] *subst.*

badminton

bad/rum [ʔb'a:drum:] *subst.* **~rum**,
~rummet, **~rum**, **~rummen**

banjë (nevojto, WC)

▷ **badkar** – vaskë banje

bag [bäg:] *subst.* **bag**, **bagen**, **bagar**
trastë (strajcë, thes, qese)

bagage [bag'a:sj] *subst.* **bagage**,
bagaget

bagazh (plaçkat që marrim me vete
në udhëtim)

bagare [ʔb'a:gare] *subst.* **bagare**,

bagaren, **bagare**, **bagarna**

bukëpjekës (furrtar)

bagatell [bagat'el:] *subst.* **bagatell**,
bagatellen, **bagateller**

çikërimë (vogëlsirë, gjë e vogël,
vogëlimë)

bageri [ba:ger'i:] *subst.* **bageri**,

bageriet, **bagerier**

furrë (vend ku piqet bukë e
prodhime të tjera brumi)

bagge [²b'ag:e] *subst.* **bagge**,
baggen, **baggar**
dash

bajonett [bajon'et:] *subst.*
bajonett, **bajonetten**,
bajonetter
bajonetë

▷ bajonett/anfall – sulm me bajoneta

bajs [baj:s] *subst.* **bajs**, **bajset**
mut (në ligj. e fëm.) (nevojë e madhe, kakë, të përgëra)

bajsar [²b'aj:sar] *verb* **bajsar**,
bajsade, **bajsat**, **bajsa**
dal jashtë (në ligj. e fëm.) (bëj kakën, pëgëj, bëj nevojën)

bak _I [ba:k] *adv.*

prapa (pas, mbrapa, nga ana e pasme)

▷ bak/gård – oborr i prapmë

▷ bak/lucka – bagazhi i makinës

bak _{II} [ba:k] *subst.* **bak**, **baken**,
bakar

prapanicë (vithe, mollaqe, të ndenjura, bythë)

bakar [²b'a:kar] *verb* **bakar**, **bakade**,
bakat, **baka**

gatuaj (bukë)

▷ bakning – pjekje, gatuarje (e bukës)

bakelse [²b'a:kelse] *subst.*

bakelse, **bakelsen**, **bakelser**
kulaç (gurabije)

bak/ficka [²b'a:kfik:a] *subst.* **~ficka**,
~fickan, **~fickor**

xhep i pasmë

▷ ha något i bakfickan – kam diçka ndërmend

bak/foten [²b'a:kfo:ten] *subst.*

keqkuptim

▷ få något om bakfoten (missuppfatta) – keqkuptoj, kuptoj diçka gabim

bak/fram [²b'a:kfram:] *adv.*

për së prapi (në të kundërt, së prapthi)

▷ ta på sig en jacka bakfram – vesh xhaketën për së prapthi

bak/grund [²b'a:kgrun:d] *subst.*
~grund, **~grunden**

sfond (*fig.* shkaku kryesor)

(prapaskenë (e ngjarjes); mjedis shoqëror)

▷ tavlan visar en liten by med ett fjäll i bakgrunden – tabloja paraqet një fshat të vogël me një mal në sfond

▷ pojkar med olika social bakgrund – djem me prejardhje të ndryshme sociale

bak/håll [²b'a:khål:] *subst.* **~håll**,
~hållet, **~håll**, **~hållen**

pritë (pusi, sulm nga një vend i fshehtë)

▷ ligga i bakhåll – i zë pusinë (dikujt)

bak/ifrån [²b'a:kifrån:n] *adv.*

praptazi (nga pas, nga prapa, nga shpina)

▷ hon smög sig på mig bakifrån – ajo u fsheh pas shpinës sime

bakom _I [²b'a:kåm:] *prep.*

pas, **prapa** (mbrapa, përtej, në anën tjetër, në anën e pasme)

▷ han satt bakom skrivbordet – ai ishte ulur pas tavolinës së punës

▷ vara bakom flötet (vara dum) – jam i trashë nga mendja, (jam budalla)

▷ bakom kulisserna (i hemlighet) – në prapaskenë, pas shpine (tinëz)

bakom _{II} [²b'a:kåm:] *adj.*

kokëtrashë (në ligj. e përdit.)

(matuf, ~e, shkundur (i, e), budalla, jointeligjent, ~e)

bakom _{III} [²b'a:kåm:] *adv.*

pas (prapa)

bak/plåt [²b'a:kplå:t] *subst.* ~plåt,
~plåten, ~plåtar

tavë pjekjeje

bak/pulver [²b'a:kpul:ver] *subst.*

~pulver, ~pulvret

sodë buke

bakre [b'a:kre] *adj.*

më prapa (që është më pas)

bak/sida [²b'a:kxi:da] *subst.*

anë e pasme (*fig.* e keqja,
disavantazhi)

bak/slag [²b'a:ksla:g] *subst.* ~slag,

~slaget, ~slag, ~slagen

disfatë (humbje, dështim)

▷ förlusten blev ett svårt bakslag –
humbja ishte një disfatë e rëndë

bak/smälla [²b'a:ksmel:a] *subst.*

~smälla, ~smällan, ~smällor

turbullirë (në *ligj.* e përdit.) (me
dhembje koke (nga pija))

bak/säte [²b'a:ksä:te] *subst.* ~säte,

~sätet

ndenjëse (e prapme) e veturës)

bak/talar [²b'a:kta:lar] *verb* ~talar,

~talade, ~talat, ~tala

përgojoj (përflas, flas keq për dikë,
shpif, marr nëpër gojë (dikë))

bakterie [bakt'e:rie] *subst.* bakterie,

bakterien, bakterier

bakter

bak/till [²b'a:ktil:] *adv.*

prapa (mbrapa, pas, në pjesën e
pasme)

bak/vänd [²b'a:kven:d] *adj.* ~vänd,

~vänt, ~vända

prapë (i, e) (mbrapshtë (i, e),
kundërt (i, e); çuditsh/ëm (i), ~me
(e))

bak/åt [b'a:kåt] *adv.*

pas (mbas, së prapthi, mbrapsht)

▷ var snäll och gå längre bakåt
i bussen! – ju lutem, shkoni më
prapa (nga fundi) i autobusit!

▷ bakåt/strävare – njeri i
prapambetur, konservator

bal [ba:l] *subst.* bal, balen, balar
deng (sasi e madhe (malli))

▷ bomullsbal – deng pambuku

bal [ba:l] *subst.* bal, balen, baler

ballo (kërcim, vallëzim)

▷ gå på bal – shkoj në ballo
(vallëzim)

▷ maskeradbal – ballo maskash

balans [bal'an:s (el. -'ang:s)] *subst.*

balans, balansen

ekuilibrë, balancë (drejtpeshim,
baraspeshim)

▷ hålla balansen – mbaj ekuilibrin

▷ tappa balansen – humb ekuilibrin

▷ bringa balans i ekonomin –
vendos ekuilibrin në ekonomi

balanserar [balans'e:rar] *verb*

balanserar, balanserade,

balanserat, balansera

balancoj (mbaj drejtpeshim, mbaj
në ekuilibër)

▷ balansera på ett räcke – balancoj
një rrethojë (parapet ballkoni)

▷ olika intressen måste balanseras
mot varandra – interesat e
ndryshëm duhen harmonizuar me
njëri-tjetrin

balett [bal'et:] *subst.* balett,

baletten, baletter

balet

▷ jazzbalett – balet xhazi

▷ balett/musik – muzikë baleti

balja [²b'al:ja] *subst.* balja, baljan,

baljor

govatë (legen, vaskë (banje))

▷ tvättbalja – govatë për larje
rrobash; kazan i makinës larëse

▷ diskbalja – lavaman për larje
enësh

balkong [balk'ång:] *subst.* balkong,

balkongen, balkonger

ballkon

▷ piskbalkong – ballkon për shkundjen (e qilimave, të shtrojave etj.)

▷ balkong/räcke – rrethinë ballkoni, parapet ballkoni

ballong [bal'ång:] *subst.* **ballong, ballongen, ballonger**

balonë (aerostat)

baltisk [b'al:tisk] *adj.* **baltisk, baltiskt, baltiska**

baltik, ~e (që vjen nga vendet baltike ose që u përket vendeve baltike, d.m.th. Estonisë, Letonisë dhe Lituanisë)

bana [²b'a:na] *subst.* **bana, banan, banor**

rrugë (kryes. *fig.*; në kuptim konkret edhe për degë transporti me shina) (pistë, shteg, udhë)

▷ levnadsbana – rrugë e jetës

▷ vägbana – rrugë, korsi automjetesh

▷ landningsbana – pistë e uljes së avionëve

band _I [ban:d] *se binder***band** _{II} [ban:d] *subst.* **band, bandet, band, banden**

konvejer (transportier)

bandar [²b'an:dar] *verb* **bandar,**

bandade, bandat, banda

incizoj (regjistroj (në shirit magnetofoni))

bandage [band'a:sj] *subst.*

bandage, bandaget, bandage, bandagen

fashë

▷ gipsbandage – fashë gjipsi (në ortopedi etj.)

▷ gipsfigur – figurë gjipsi

bandit [band'i:t] *subst.* **bandit,**

banditen, banditer

bandit (kriminel, keqbërës)

band/spelare [²b'an:dspe:lare]

subst. **~spelare, ~spelaren,**

~spelare, ~spelarna

magnetofon

bandy [b'an:dy] *subst.* **bandy, bandyn**

bandi (lojë në akull me shkop dhe top)

▷ bandy/klubba – shkopi i lojës bandi

bank [bang:k] *subst.* **bank, banken, banker**

bankë

bantar [²b'an:tar] *verb* **bantar,**

bantade, bantat, banta

dobësohem (*fig.* ul, pakësoj, zvogëloj) (bie në peshë, cungoj, shkurtoj)

▷ han bantade tjugo kilo – ai u dobësua 20 kilogramë

▷ budgeten har bantats ner kraftigt – buxheti u cungua shumë

bar _I [ba:r] *adj.* **bar, bart, bara**

lakuriq (zhveshur (i, e), cullak, ~e, picak, ~e)

▷ sova under bar himmel – fle në qiell të hapur

bar _{II} [ba:r] *subst.* **bar, baren, barer**

bar-pijetore (restorant, lokal i vogël)

▷ grillbar – restorant me mishra të pjekura

▷ bar/servering – shërbim në bar

bar se bära**bara** [²b'a:ra] *adv.*

vetëm (thjesht)

▷ jag har bara en krona kvar – më ka mbetur vetëm një koronë

barack [bar'ak:] *subst.* **barack,**

baracken, baracker

barakë (katua, strehinë)

barbarisk [barb'a:risk] *adj.*

barbarisk, barbariskt, barbariska

barbar, ~e (paqytetëruar (i, e), primitiv, ~e, çnjerëzor, ~e)

bar/fota [²b'a:rfo:ta] *adj.*

zbathur (i, e) (zbatharak, ~e, këmbëzbathur)

▷ gå barfota – eci zbathur

bar/huvad [²b'a:rhu:vad] *adj.*

~huvad, ~huvat, ~huvade

kokëzbuluar (kokëjashtë (pa kapelë))

bark [bar:k] *subst.* **bark, barken**

lëvore (lëvozhgë (pemësh))

barlast [²b'a:r_las:t el. b'a:las:t]

subst. **barlast, barlasten,**

barlaster

barrë e rëndë (*fig.* peshë,

pengesë e panevojshme)

(ngarkesë e rëndë në fund të vaporit për siguri)

barn [ba:r_n] *subst.* **barn, barnet,**

barn, barnen

fëmijë

▷ bli med barn – mbetem shtatzënë

▷ passa barn – kujdesem për fëmijët

▷ barn/hem – shtëpi e fëmijëve

▷ barn/bok – libër për fëmijë

barn/barn [²b'a:r_nba:r_n] *subst.*

~barn, ~barnet, ~barn, ~barnen

nip, mbesë

barn/bidrag [²b'a:r_nbi:dra:g]

subst. **~bidrag, ~bidraget,**

~bidrag, ~en

ndihmë ekonomike (për familjet me fëmijë)

barndom [²b'a:r_ndom:] *subst.*

barndom, barndomen

fëmijëri (edhe *fig.*) (vegjëli, foshnjëri)

▷ barndoms/hem – shtëpi e fëmijërisë

barn/morska [²b'a:r_nmor_s:ka]

subst. **~morska, ~morskan,**

~morskor

mami (infermiere)

barn/sjukdom [²b'ar_

nsju:kdom:] *subst.* **~sjukdom,**

~sjukdomen, ~sjukdomar

sëmundje fëmijësh (*fig.* vështirësi të fillimit) (sëmundje infektive që prek fëmijët (p.sh. fruthi, shytat, lia e bardhë))

barn/slig [²b'a:r_nslig] *adj.* **~slig,**

~sligt, ~sliga

foshnjarak, ~e (foshnjor, ~e,

papjekur (i, e)

▷ var inte barnslig! – mos u bë fëmijë! mos bëj kalamallëqe!

barn/vakt [²b'a:r_nvak:t] *subst.* **~vakt,**

~vakten, ~vakter

dado (kujdestare fëmijësh)

▷ sitta barnvakt – ruaj fëmijën, mbaj fëmijën

barometër [barom'e:ter] *subst.*

barometer, barometern, barometrar

barometër (matës i shtypjes atmosferike)

▷ väljarbarometer – barometër i zgjedhjeve

barr [bar:] *subst.* **barr, barret, barr,**

barren

halë (pishe)

▷ barr/skog – pyll halor

▷ barr/träd – dru halor

▷ tallbarr – halë pishe

barrikad [barik'a:d] *subst.* **barrikad,**

barrikadën, barrikader

barrikadë (edhe *fig.* pengesë e përkohshme)

basket [b'a:sket] *subst.* **basket,**

basketen

basketboll

basket/boll [²b'a:sketbål:] *subst.*

~boll, ~bollen

basketboll

bas/linje [²b'a:slin:je] *subst.* **~linje,**

~linjen, ~linjer

vijat kryesore në fushën e tenisit

bassäng [bas'eng:] *subst.*

bassäng, bassängen, bassänger pishinë

▷ simbassäng – pishinë për t'u larë ose për gara noti, basen

basta [b'as:ta] *interj.*

mjaft!

bastar [²b'as:tar] *verb* **bastar,**

bastade, bastat, basta

bëj banjë me avull (në *ligj. e përdit.*)

bastu [²b'as:tu] *subst.* **bastu,**

bastun, bastur

banjë avulli

▷ bada bastu – bëj banjë avulli

bataljon [batalj'o:n] *subst.* **bataljon,**

bataljonen, bataljoner

batalion

batong [bat'ång:] *subst.* **batong,**

batongen, batonger

shkop (gome) (shkop policie, skeptër)

BB [²b'e:be:] *förk.*

reparti i lindjes (maternitet)

ber [be:r] *verb* **ber, bad, bett, be**

lut (kërkoj)

▷ be om ursäkt – kërkoi falje për (gabimin)

▷ han bad att få återkomma – ai kërkoi të vinte përsëri

bearbetar [²b'e:arbe:tar] *verb*

bearbetar, bearbetade, bearbetat, bearbeta

përpunoj (shqyrtoj, trajtoj, përshtat, merrem me, kultivoj)

▷ bearbeta ett problem – merrem me një problem

▷ bearbeta ett material – përpunoj një material

bedragare [²bedr'a:gare]

subst. **bedragare, bedragaren,**

bedragare, bedragarna

mashtrues, ~i (gënjeshtar, ~i)

bedrägeri [bedrä:ger'i:] *subst.*

bedrägeri, bedrägeriet,

bedrägerier

mashtim (dredhim, gënjim, hile)

▷ dömas för grovt bedrägeri – dënohet për mashtim të madh

bedrövad [bedr'ö:vad] *adj.*

bedrövad, bedrövat, bedrövade

brengosur (i, e) (pikëlluar (i, e),

trishtuar (i, e), hidhëruar (i, e))

bedömer [bed'öm:er] *verb*

bedömer, bedömde, bedömt,

bedöm, bedöma

vlerësoj (vendos, konsideroj, gjykoj)

▷ det är svårt att bedöma de ekonomiska effekterna – është vështirë të vlerësohen efektet ekonomike

▷ bedöma ett prov – vlerësoj një provim

bedömning [bed'öm:ning] *subst.*

bedömning, bedömningen,

bedömningar

gjykim (vlerësim)

▷ göra en säker bedömning av situationen – bëj një vlerësim të mirë të situatës; gjykoj mirë situatën

bedövning [bed'ö:vning] *subst.*

bedövning, bedövningen,

bedövningar

anestezi (narkozë)

▷ bedövning/medel – mjete anestezie

befaller [bef'al:er] *verb* **befaller,**

befalld, befallt, befall, befalla

urdhëroj (jap urdhër, komandoj, porosit)

befattar sig [bef'at:ar_sej] *verb*

befattar sig, befattade, befattat,

befatta

merrem me (jepem pas)

▷ jag befattar mig inte med sådant
– nuk merrem me gjëra të tilla

befattning [bef'at:ning] *subst.*

befattning, befattningen,

befattningar

detyrë, punë

▷ jag befattar mig inte med sådant
– nuk merrem me gjëra të tilla

▷ en befattning som museichef –
një detyrë (punë) si drejtues muzeu

befintlig [bef'in:tlig] *adj.* **befintlig,**

befintligt, befintliga

ekzistues, ~e (që ekziston)

▷ den befintliga bebyggelsen ska
bevaras – godinat ekzistuese do të
ruhen

befogad [bef'o:gad] *adj.* **befogad,**

befogat, befogade

justifikuar (i, e) (justifikuesh/ëm (i),

~me (e), përligjsh/ëm (i), ~me (e),
legjitim, ~e, drejtë (i, e))

▷ kritiken är befogad – kritika është
me vend

befolkning [bef'ål:kning] *subst.*

befolkning, befolkningen,

befolkningar

popullsi (popullatë, popull, banorë)

▷ civilbefolkning – popullsi civile,
qytetarët, banorët

▷ befolknings/grupp – grup
njerëzish

befriar [befr'i:ar] *verb* **befriar,**

befriade, befriat, befria

çliroj (liroj, lëshoj (një të
burgosur))

▷ landet befriades från diktatur –
vendi u çlirua nga diktatura

befrielse [befr'i:else] *subst.*

befrielse, befrielsen, befrielser

çlirim (lirim, largim, shkarkim (nga
detyra))

▷ landet befriades från diktatur –
vendi u çlirua nga diktatura

▷ befrielse/rörelse – lëvizje çlirimtare

befruktar [befr'uk:tar] *verb* **befruktar,**

befruktade, befruktat, befrukta

mbars (pllenoj, fekondo, pjalmoj)

(fig. nxit, frymëz, stimuloj; ngjall,
shkaktoj, stimuloj (besim))

befäl [bef'ä:l] *subst.* **befäl, befälet,**

befäl, befälen

komandë (komandim, urdhër;
drejtues, komandant)

▷ föra befäl – komandoj, jap urdhër

▷ soldater och befäl – ushtarë dhe
oficerë

▷ befäl/havare – komandant

begraver [begr'a:ver] *verb*

begraver, begravde, begravt,

begrav, begrava

varros (fig. gropos, fsheh)

▷ han begravdes i hemlighet – ai u
varros në fshehtësi

▷ ligga begravd – jam i/e varrosur

begravning [begr'a:vning] *subst.*

begravning, begravningen,

begravningar

varrim

▷ begravnings/entreprenör –
sipërmarrës varrimesh

▷ begravnings/marsch – kortezh i
përmortshëm

begrepp [begr'ep:] *subst.* **begrepp,**

begreppet, begrepp, begreppen

koncept (nacion, ide, përfytyrim,
mendim, kuptim)

▷ begreppet "standard" – koncepti
"standard"

begriper [begr'i:per] *verb* **begriper,**

begrep, begripit, begrip, begripa

kuptoj (marr vesh, gjykoj, marr me
mend (një çështje))

begränsar [begr'en:sar] *verb*

begränsar, begränsade,

begränsat, begränsa

kufizoj (reduktoj, përmbahem)

▷ Sverige måste begränsa importen – Suedia duhet ta kufizojë importin

▷ begränsa sig till något – i përmbahem diçkaje

begår [beg'å:r] *verb* **begår, begick, begått, begå**
bëj, kryej

▷ begå ett brott – bëj një krim

begåvad [beg'å:vad] *adj* **begåvad, begåvat, begåvade**
aftë (i, e) (talentuar (i, e), me dhunti, inteligjent, ~e)

begåvning [beg'å:vning] *subst.*
begåvning, begåvningen, begåvningar

dhunti (pirrje, talent)

begär [bej'ä:r] *subst.* **begär, begäret, begär, begären**
dëshirë e madhe (dëshirim, mall)

begär [bej'ä:r] *verb* **begär, begärde, begärt, begär, begära**
lut, kërkoj (dëshiroj)

begäran [bej'ä:ran] *subst.* **begäran, begäran**
lutje (kërkesë, dëshirë)

▷ på egen begäran – me kërkesën e vet

behaglig [beh'a:glig] *adj.* **behaglig, behagligt, behagliga**

këndsh/ëm (i), ~me (e) (pëlqyesh/ëm (i), ~me (e), mirë (i, e))

▷ ett behagligt avbrott i rutinen

– një ndërprerje e këndshme e

ruinës

behandlar [beh'an:dlar] *verb*
behandlar, behandlade, behandlat, behandla
trajtoj (sillem, kujdesem)

behandling [beh'an:ding] *subst.*
behandling, behandlingen, behandlingar
trajtim (mjekim)

▷ komma under behandling – marr një dorë, bëj zap, fut nën kontroll

behov [beh'o:v] *subst.* **behov, behovet, behov, behoven**
nevojë (hall, zor)

▷ vara i behov av vård – kam nevojë për mjekim

▷ han har behov av att höra andras åsikter – ai ka nevojë të dëgjojë mendimet e të tjerëve

behå [²b'e:hå:] *subst.* **behå, behån, behå, behåna**
gjimbajtëse (sutiena)

behåller [beh'ål:er] *verb*
behåller, behöll, behållit, behåll, behålla

ruaj (mbaj)

behållare [beh'ål:are] *subst.*
behållare, behållaren, behållare, behållarna

enë (kuti, kontejner, cisternë, rezervuar)

behändig [beh'en:dig] *adj.*
behändig, behändigt, behändiga
volitsh/ëm (i), ~me (e) (zhdërvjellët (i, e), rehatsh/ëm (i), ~me (e))

behärskar [beh'är_s:kar] *verb* **behärskar, behärskade, behärskat, behärska**

sundoj (kontrolloj, zotëroj)

▷ behärska ett landområde – kontrolloj një zonë

▷ behärska ett språk – zotëroj një gjuhë

behörig [beh'ö:rig] *adj.* **behörig, behörigt, behöriga**

kompetent, ~e (përkatës, ~e, përshtatsh/ëm (i), ~me (e), volitsh/ëm (i), ~me (e))

▷ endast två sökande befanns

behöriga att söka tjänsten – vetëm

dy kandidatë i plotësonin kushtet për të kërkuar postin (vendin e punës)

▷ på behörigt avstånd – në largësinë e duhur

behöver [beh'ö:ver] *verb* **behöver, behövde, behövt, behöva më duhet** (kam nevojë për...)

▷ jag behöver hundra kronor – më duhen njëqind korona

▷ han behövde hjälp – ai kishte nevojë për ndihmë

beige [be:sj (el. bä:sj)] *adj.* **beige, beigea**

mushkëllyer (i, e) (ngjyrë kafe e çelur në të verdhë)

▷ jag träffade en gammal bekant på gatan – takova në rrugë një të njohur të vjetër

bekant [bek'an:t] *adj.* **bekant, bekant, bekanta**

dëgjuar (i, e) (njohur (i, e), përmendur (i, e), që njihet)

▷ jag träffade en gammal bekant på gatan – takova në rrugë një të njohur të vjetër

bekantar sig [bek'an:tar_sej] *verb* **bekantar sig, bekantade, bekantat, bekanta njihem**

bekantskap [bek'an:tska:p] *subst.* **bekantskap, bekantskapen, bekantskaper**

njohje, njohuri

▷ bekantskaps/krets – rrethi i të njohurve

